

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në promovimin, garantimin, si dhe nxitjen e standardeve më të larta në ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut, të cilat i ka në thelb të veprimtarisë së tij, si e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni në intensifikimin e përpjekjeve për përafrimin e kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë e tij me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian dhe akteve të tjera ndërkombëtare me fuqi detyruese;

Duke vlerësuar rolin e veçantë në garantimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga përhapja e virusit Covid-19 nëpërmjet miratimit të udhëzuesëve dhe dhënies së orientimeve për kontrollues publik dhe privat për interpretimin e legjislacionit dhe përpunimin e drejtë të të dhënave personale;

Duke mbështetur dhe inkurajuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, medien, publikun, si dhe me institucionet e tjera publike në nivel qendror e vendor,

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2020 dhe konstaton se:

Është angazhuar në forcimin e rolit të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe publikimit të “politikave të privatësisë” në faqen zyrtare të kontrolluesve publikë dhe privatë, si një hallkë e rëndësishme në procesin e garantimit të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale;

Është angazhuar në monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat online, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ose sektorë që përpunojnë të

dhëna sensitive, duke hartuar edhe një raport të posaçëm për rezultatet, gjendjen dhe nivelin e adresimit të problematikave nga institucionet e përfshira;

I ka kushtuar vëmendje të veçantë sektorit të shëndetësisë, diktuar natyrshëm nga situata e pandemisë e krijuar nga përhapja e virusit Covid-19 nëpërmjet dhënies së asistencës dhe mbështetjes ndaj organeve ligjzbatuese të pozicionuara në vijën e parë të luftës kundër Covid-19 duke miratuar akte të dedikuara posaçërisht dhënies së orientimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Ka rritje të numrit të rekomandimeve në raport me vitin 2019 për kontrollues publikë dhe privatë duke synuar ndërgjegjësimin e tyre;

Ka luajtur një rol proaktiv në kuadër të përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, siç është përafrimi i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* të BE-së në këtë fushë, si dhe miratimi në parim i protokollit ndryshues të Konventës 108;

Ka dhënë kontribut kryesor në plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, si miratimi në parim i Konventës së Këshillit të Europës për aksesin në dokumentet zyrtare dhe përafrimi i Direktivës 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;

Ka vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e ankesave, si dhe nxitjen e autoriteteve publike për të vënë në dispozicion të publikut informacionin pa kërkesë;

Ka realizuar dy indekse të transparencës proaktive, përkatësisht të institucioneve qendrore dhe të varësisë dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës;

Ka kryer hetime administrative me fokus monitorimin e programeve të transparencës duke rekomanduar ose vendosur sanksione administrative ndaj autoriteteve publike, të cilat nuk e kanë zbatuar atë;

Është angazhuar në organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese për respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale duke shfrytëzuar mjetet digjitale të komunikimit, si takime online, *webinar*-e, *newsletter* mujore etj.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2021, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

- Të vijojë të mbështesë dhe monitorojë autoritetet publike për vënien në zbatim të Programit të Transparencës të rishikuar dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve;

- Të gjejë mekanizmat për të ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;

- Të ndërmarrë hapa institucionalë dhe ligjorë me autoritetet përkatëse për adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (trajtimi i kërkesave dhe ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-albania*).

- Të vijojë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publikë dhe privatë të sektorit të kujdesit shëndetësor.

- Të angazhohet në përgatitjen e një rekomandimi unifikues në fushën e shëndetësisë;

- Të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e arsimit, veçanërisht në lidhje me masat teknike dhe organizative të marra nga kontrollues të këtij sektori për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale në kontekstin e mësimdhënies online, të diktuar nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë Covid-19;

- Të monitorojë dhe mbikëqyrë respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë.

- Të përforcojë bashkërendimin institucional me kontrolluesit publikë për të vijuar mbikëqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat online, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kontrolluesit publikë dhe privatë të sektorit të kujdesit shëndetësor;

- Të vijojë me dhënien e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër);

- Të fuqizojë dhënien e kontributit dhe angazhimin aktiv në grupet ndërkombëtare të punës në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Europiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);

- Të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuese, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë, me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentët ose përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.

Miratuar në datën 3.6.2021